



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics



Tregtia e Jashtme e Mallrave

Tetor 2022

Prishtinë, 22.11.2022: Agjencia e statistikave të Kosovës (ASK) ka filluar të publikojë të dhënat për Importin dhe Eksportin e Kosovës që nga viti 2001, por si të dhëna të besueshme konsiderohen nga viti 2005.

Publikimi për Tregtinë e Jashtme është i bazuar në të dhënat e Shërbimit Doganor të Kosovës.

Të gjitha publikimet mujore janë të dhëna paraprake, të cilat ndryshojnë nga dhënat vjetore (përfundimtare). Ky publikim përmban të dhëna sipas qarkullimit të mallrave, procedurave statistikore, seksioneve të Klasifikimit Ndërkombëtar Standard i Tregtisë (SITC), seksioneve sipas Sistemit të Harmonizuar (HS) dhe vendeve partnere. Metodologjia dhe metodat janë përshtatur për të integruar dhe krahasuar statistikatat e tregtisë së jashtme të mallrave në nivel ndërkombëtar.

Importet janë paraqitur sipas vendit të origjinës, ndërsa eksportet sipas destinacionit.

Propozimet, sugjerimet dhe vërejtjet tuaja mund të dërgoni në adresën e ueb infoask@rks-gov.net

Publikimin përgatiten:

Ismajl Sahiti - Z.v. i Drejtorit të Departamentit Ekonomik
Mensure Çerkezi - Z.v.Udhëheqëse e Divizionit të Statistikave Ekonomike

Z.v i Kryeshefit Ekzekutiv, ASK
Ilir T. Berisha

Lista e shkurtesave

ASK	-	Agjencia e Statistikave të Kosovës
F.O.B	-	I lirë në bord (Free on board)
C.I.F.	-	Kosto, Sigurim, Transport (Cost, Insurance, Freight)
BE	-	Bashkimi Evropian
NK	-	Nomenklaturë e Kombinuar
KSTJ	-	Klasifikimi standard i tregtisë së jashtme
DUD	-	Dokument Unik Doganor
SH	-	Sistemi Harmonizuar
SNO	-	Standardet Ndërkombëtare të Organizimit
CEFTA	-	Marrëveshja e Tregtisë së Lirë me Shtetet e Evropës Juglindore
EFTA	-	Shoqata Evropiane për Tregtinë e Lirë
s.d.t	-	Specifikuara diku tjetër
s.s	-	suspension sistem (sistem i pezulluar)
d.s	-	drawback sistem (sistemi me kthim)
€	-	euro

Simbolet

:	-	Nuk ka të dhëna
0	-	Më pak se gjysma e njësisë së përdorur
—	-	Nuk aplikohet

Përmbajtja

	Faqe
Tab. 1: Qarkullimi i mallrave në tregtinë e jashtme	4
Tab. 2: Qarkullimi i mallrave në tregtinë e jashtme, kumulativ	5
Tab. 3: Eksportet dhe Importet sipas standardeve	6
Tab. 4: Eksportet dhe Importet sipas seksioneve të KSTJ (SITC).....	6
Tab. 5: Eksportet dhe Importet sipas seksioneve në vlerë dhe në përqindje	7
Tab. 6: Eksportet sipas vendeve në vlerën dhe në përqindje	8
Tab. 7: Importet sipas vendeve në vlerën dhe në përqindje	9
Shpjegime metodologjike	10

Tab. 1: Qarkullimi i mallrave në tregtinë e jashtme

(në mijë Euro)

Periudha	Eksportet (FOB)	Importet (CIF)	Bilanci tregtar	Përqindja e mbulimit
1	2	3	4=2-3	5=2/3
2001	10.559	684.500	-673.941	1,5
2002	27.599	854.758	-827.159	3,2
2003	35.621	973.265	-937.644	3,7
2004	56.567	1.063.347	-1.006.780	5,3
2005	56.283	1.157.492	-1.101.209	4,9
2006	110.774	1.305.879	-1.195.105	8,5
2007	165.112	1.576.186	-1.411.074	10,5
2008	198.463	1.928.236	-1.729.773	10,3
2009*	165.328	1.937.539	-1.772.211	8,5
2010	295.957	2.157.725	-1.861.769	13,7
2011	319.165	2.492.348	-2.173.184	12,8
2012	276.100	2.507.609	-2.231.509	11,0
2013	293.842	2.449.064	-2.155.221	12,0
2014	324.543	2.538.337	-2.213.794	12,8
2015	325.294	2.634.693	-2.309.399	12,3
2016	309.627	2.789.491	-2.479.864	11,1
2017	378.010	3.047.018	-2.669.007	12,4
2018	367.500	3.347.007	-2.979.507	11,0
2019	383.491	3.496.942	-3.113.451	11,0
2020	474.884	3.296.635	-2.821.751	14,4
2021	755.726	4.684.198	-3.928.472	16,1
01-2021	42.498	235.853	-193.356	18,0
02-2021	48.408	301.678	-253.270	16,0
03-2021	61.797	382.499	-320.702	16,2
04-2021	61.107	384.552	-323.445	15,9
05-2021	57.826	366.037	-308.212	15,8
06-2021	72.913	393.322	-320.408	18,5
07-2021	62.277	430.148	-367.871	14,5
08-2021	64.992	417.617	-352.625	15,6
09-2021	75.608	452.167	-376.559	16,7
10-2021	72.574	428.539	-355.964	16,9
11-2021	70.697	431.830	-361.133	16,4
12-2021	65.028	459.956	-394.928	14,1
01-2022	64.220	338.114	-273.894	19,0
02-2022	65.256	414.770	-349.515	15,7
03-2022	88.600	493.917	-405.317	17,9
04-2022	80.997	462.742	-381.745	17,5
05-2022	76.033	443.892	-367.859	17,1
06-2022	74.642	492.832	-418.190	15,1
07-2022	76.298	502.414	-426.116	15,2
08-2022	84.891	526.829	-441.938	16,1
09-2022	77.059	478.167	-401.109	16,1
10-2022	86.402	488.774	-402.372	17,7

2022, janë të dhëna preliminare

*) Të dhënat e vitit 2009 për import ndryshojnë nga publikimet e më hershme

Tab. 2: Qarkullimi i mallrave në tregtinë e jashtme, kumulativ

(në mijë Euro)

Periudha	Eksportet (FOB)	Importet (CIF)	Bilanci tregtar	Përqindja e mbulimit
1	2	3	4=2-3	5=2/3
01-2020	28.939	221.102	-192.163	13,1
02-2020	64.834	484.476	-419.642	13,4
03-2020	96.997	736.545	-639.548	13,2
04-2020	129.680	930.528	-800.848	13,9
05-2020	168.446	1.169.606	-1.001.160	14,4
06-2020	213.049	1.460.416	-1.247.367	14,6
07-2020	255.685	1.766.736	-1.511.051	14,5
08-2020	290.002	2.030.046	-1.740.043	14,3
09-2020	331.728	2.317.340	-1.985.612	14,3
10-2020	382.362	2.635.025	-2.252.664	14,5
11-2020	428.160	2.940.767	-2.512.607	14,6
12-2020	474.884	3.296.635	-2.821.751	14,4
01-2021	42.498	235.853	-193.356	18,0
02-2021	90.906	537.531	-446.625	16,9
03-2021	152.703	920.030	-767.327	16,6
04-2021	213.810	1.304.582	-1.090.772	16,4
05-2021	271.636	1.670.619	-1.398.984	16,3
06-2021	344.549	2.063.941	-1.719.392	16,7
07-2021	406.826	2.494.090	-2.087.263	16,3
08-2021	471.818	2.911.706	-2.439.888	16,2
09-2021	547.426	3.363.873	-2.816.447	16,3
10-2021	620.001	3.792.412	-3.172.411	16,3
11-2021	690.698	4.224.242	-3.533.544	16,4
12-2021	755.726	4.684.198	-3.928.472	16,1
01-2022	64.220	338.114	-273.894	19,0
02-2022	129.476	752.885	-623.409	17,2
03-2022	218.076	1.246.801	-1.028.726	17,5
04-2022	299.072	1.709.543	-1.410.471	17,5
05-2022	375.105	2.153.435	-1.778.330	17,4
06-2022	449.747	2.646.267	-2.196.520	17,0
07-2022	526.045	3.148.681	-2.622.636	16,7
08-2022	610.936	3.675.511	-3.064.575	16,6
09-2022	687.995	4.153.678	-3.465.683	16,6
10-2022	774.396	4.642.452	-3.868.056	16,7

Tab. 3: Eksportet dhe Importet sipas standardeve

Procedurat statistikore						(në mijë Euro)
		Tetor - 2021		Tetor - 2022		Indices
		Vlera	%	Vlera	%	2022/ 2021
Gjithsejt Eksportet		72.574	100,0	86.402	100,0	119
1	Eksportet normale	68.926	95,0	82.367	95,3	119,5
2	Eksportet pas përpunimit të brendshëm	3.569	4,9	36	0,0	1,0
3	Eksportet për përpunim të jashtëm	80	0,1	3.998	4,6	:
9	Eksportet që nuk regjistrohen ne dogana	:	:	:	:	:
Gjithsejt Importet		428.539	100,0	488.774	100,0	114
1	Importet normale	426.059	99,4	485.471	99,3	113,9
2	Importet për përpunim të brendshëm(S.S)	2.465	0,6	3.291	0,7	133,5
3	Importet pas përpunimit të jashtëm	15	0,0	12	0,0	:
9	Importet që nuk regjistrohen ne dogana	:	:	:	:	:

Tab. 4: Eksportet dhe Importet sipas seksioneve të KSTJ (SITC)

Seksionet sipas KSTJ						(në mijë Euro)
		Tetor - 2021		Tetor - 2022		
		Vlera	%	Vlera	%	
Gjithsej		72.574	100,0	86.402	100,0	
0	Ushqime dhe kafshë të gjalla	5.545	7,6	8.603	10,0	
1	Pije dhe duhan	3.645	5,0	2.917	3,4	
2	Materiale të papërpunuara	10.387	14,3	9.459	10,9	
3	Lëndë djegëse	1.659	2,3	15.404	17,8	
4	Yndyrna bimore dhe shtazore	266	0,4	887	1,0	
5	Produkte kimike	4.333	6,0	6.329	7,3	
6	Mallra të përpunuara	17.506	24,1	17.481	20,2	
7	Makineri e pajisje transporti	2.266	3,1	2.950	3,4	
8	Mallra të tjera të përpunuara	26.953	37,1	22.356	25,9	
9	Mallra të pa klasifikuara diku tjetër	14	0,0	16	0,0	
		Importet (CIF)				
Gjithsej		428.539	100,0	488.774	100,0	
0	Ushqime dhe kafshë të gjalla	64.606	15,1	72.720	14,9	
1	Pije dhe duhan	13.234	3,1	15.794	3,2	
2	Materiale të papërpunuara	6.902	1,6	5.422	1,1	
3	Lëndë djegëse	52.883	12,3	74.080	15,2	
4	Yndyrna bimore dhe shtazore	4.721	1,1	4.999	1,0	
5	Produkte kimike	52.582	12,3	69.848	14,3	
6	Mallra të përpunuara	104.728	24,4	98.439	20,1	
7	Makineri e pajisje transporti	84.047	19,6	94.459	19,3	
8	Mallra të tjera të përpunuara	44.647	10,4	52.734	10,8	
9	Mallra të pa klasifikuara diku tjetër	189	0,0	278	0,1	

Tab. 5: Eksportet dhe Importet sipas seksioneve në vlerë dhe në përqindje

(në mijë Euro)

Kodi	Seksionet sipas Sistemit të Harmonizuar(HS)	Tetor - 2021		Tetor - 2022	
		Vlera	%	Vlera	%
		Eksportet (FOB)			
	Gjithsejt	72.574	100,0	86.402	100,0
1	Kafshë të gjalla, produkte me origjinë kafshe	252	0,3	1.224	1,4
2	Produkte bimore	3.594	5,0	4.621	5,3
3	Yndyrëra	272	0,4	887	1,0
4	Ushqime të përg. pije dhe duhan	5.769	7,9	6.175	7,1
5	Produkte minerale	4.286	5,9	17.861	20,7
6	Produkte të industrisë kimike	1.514	2,1	1.988	2,3
7	Plastikë,gomë dhe artikuj prej tyre	8.662	11,9	11.481	13,3
8	Lëkurë dhe artikuj prej tyre	434	0,6	778	0,9
9	Druri dhe artikuj druri	1.220	1,7	1.120	1,3
10	Letër dhe artikuj prej letëre	890	1,2	865	1,0
11	Tekstil dhe artikuj tekstili	1.937	2,7	2.672	3,1
12	Veshëmbathje të këmbëve	414	0,6	332	0,4
13	Art.prej guri, allçie, prod. qeramike dhe qelqi	1.855	2,6	2.988	3,5
14	Perla, gurë të çmuar, metale të çmuara etj.	382	0,5	1.113	1,3
15	Metale bazë dhe artikuj prej tyre	19.268	26,5	15.950	18,5
16	Makineri, paisje mekanike dhe elektrike	2.133	2,9	2.366	2,7
17	Mjetet e transportit	370	0,5	798	0,9
18	Instr.optike,mjeksore,fotog.,muzikore etj.	70	0,1	331	0,4
19	Armët dhe municionet	:	:	:	:
20	Artikuj të ndryshëm të prodhura	19.173	26,4	12.833	14,9
21	Veprat e artit	78	0,1	19	0,0
		Importet (CIF)			
	Gjithsejt	428.539	100,0	488.774	100,0
1	Kafshë të gjalla, produkte me origjinë kafshe	17.025	4,0	23.101	4,7
2	Produkte bimore	16.206	3,8	16.466	3,4
3	Yndyrëra	5.183	1,2	5.483	1,1
4	Ushqime të përg. pije dhe duhan	45.932	10,7	49.945	10,2
5	Produkte minerale	60.711	14,2	82.016	16,8
6	Produkte të industrisë kimike	30.562	7,1	49.984	10,2
7	Plastikë,gomë dhe artikuj prej tyre	31.873	7,4	29.287	6,0
8	Lëkurë dhe artikuj prej tyre	1.016	0,2	1.067	0,2
9	Druri dhe artikuj druri	10.440	2,4	10.106	2,1
10	Letër dhe artikuj prej letëre	6.059	1,4	6.889	1,4
11	Tekstil dhe artikuj tekstili	25.274	5,9	28.026	5,7
12	Veshëmbathje të këmbëve	5.095	1,2	6.118	1,3
13	Art.prej guri, allçie, prod. qeramike dhe qelqi	17.459	4,1	14.176	2,9
14	Perla, gurë të çmuar, metale të çmuara etj.	495	0,1	1.093	0,2
15	Metale bazë dhe artikuj prej tyre	55.245	12,9	50.257	10,3
16	Makineri, paisje mekanike dhe elektrike	53.391	12,5	57.757	11,8
17	Mjetet e transportit	31.301	7,3	37.138	7,6
18	Instr.optike,mjeksore,fotog.,muzikore etj.	4.423	1,0	6.965	1,4
19	Armët dhe municionet	309	0,1	477	0,1
20	Artikuj të ndryshëm të prodhura	10.347	2,4	12.141	2,5
21	Veprat e artit	190	0,0	280	0,1

Tab. 6: Eksportet sipas vendeve në vlerën dhe në përqindje

(në mijë Euro)

Vendet	Tetor - 2021		Tetor - 2022	
	Vlera	%	Vlera	%
	Eksportet (FOB)			
Gjithsej	72.574	100,0	86.402	100,0
27 vendet e BE_së	22.834	31,5	37.787	43,7
Austria	778	1,1	1.502	1,7
Belgjika	1.265	1,7	1.574	1,8
Danimarka	657	0,9	132	0,2
Franca	961	1,3	1.450	1,7
Gjermania	6.838	9,4	8.708	10,1
Greqia	467	0,6	588	0,7
Holanda	1.937	2,7	2.870	3,3
Hungaria	109	0,2	278	0,3
Irlanda	48	0,1	36	0,0
Italia	4.353	6,0	4.658	5,4
Luksemburg	48	0,1	52	0,1
Polonia	290	0,4	1.334	1,5
Republika Çeke	109	0,2	74	0,1
Slovakia	45	0,1	96	0,1
Slovenia	1.317	1,8	12.224	14,1
Spanja	305	0,4	150	0,2
Suedia	296	0,4	315	0,4
Rumani	191	0,3	391	0,5
Bullgaria	1.923	2,6	626	0,7
Kroacia	794	1,1	633	0,7
Të tjera të BE_së	104	0,1	97	0,1
Cefta	24.161	33,3	28.599	33,1
Shqipëria	8.875	12,2	7.553	8,7
Maqedonia	7.869	10,8	11.131	12,9
Mali i Zi	2.942	4,1	3.490	4,0
Serbia	3.691	5,1	5.502	6,4
Bosnja dhe Hercegovina	785	1,1	924	1,1
Moldavia	:	:	1	0,0
EFTA	6.170	8,5	7.346	8,5
Zvicra	6.141	8,5	7.326	8,5
Icelanda	:	:	1	0,0
Norvegjia	29	0,0	19	0,0
Liechtensten	:	:	:	:
Vendet tjera evropiane	1.803	2,5	3.109	3,6
Turqia	1.538	2,1	1.379	1,6
Ukraina	6	0,0	4	:
Britania e Madhe	259	0,4	1.726	2,0
Vendet tjera jo evropiane	15.161	20,9	8.180	9,5
SHBA	14.750	20,3	8.149	9,4
Canada	359	0,5	23	0,0
Brazili	16	0,0	:	:
Mexico	36	0,0	8	0,0
Vendet nga Azija	274	0,4	87	0,1
Japonia	19	0,0	0	0,0
Kina	253	0,3	3	0,0
India	3	0,0	84	0,1
Të tjera	2.171	3,0	1.293	1,5

Tab. 7: Importet sipas vendeve në vlerën dhe në përqindje

(në mijë Euro)

Vendet	Tetor - 2021		Tetor - 2022	
	Vlera	%	Vlera	%
	Importet (CIF)			
Gjithsej	428.539	100,0	488.774	100,0
27 vendet e BE_së	175.764	41,0	203.387	41,6
Austria	5.921	1,4	6.890	1,4
Belgjika	2.884	0,7	19.763	4,0
Danimarka	1.177	0,3	3.466	0,7
Franca	5.304	1,2	5.874	1,2
Gjermania	50.044	11,7	52.012	10,6
Greqia	15.245	3,6	23.576	4,8
Holanda	5.099	1,2	3.506	0,7
Hungaria	5.213	1,2	7.857	1,6
Irlanda	436	0,1	918	0,2
Italia	26.119	6,1	22.772	4,7
Luksemburg	162	0,0	131	0,0
Polonia	9.331	2,2	9.503	1,9
Republika Çeke	3.313	0,8	5.551	1,1
Sllovakia	1.053	0,2	1.172	0,2
Sllovenia	15.323	3,6	9.197	1,9
Spanja	7.965	1,9	7.978	1,6
Suedia	727	0,2	1.148	0,2
Rumani	3.411	0,8	4.880	1,0
Bullgaria	7.567	1,8	6.729	1,4
Kroacia	8.397	2,0	8.719	1,8
Të tjera të BE_së	1.072	0,3	1.745	0,4
Cefta	90.375	21,1	83.200	17,0
Shqipëria	26.968	6,3	21.651	4,4
Maqedonia	23.810	5,6	19.510	4,0
Mali i Zi	2.264	0,5	1.690	0,3
Serbia	31.186	7,3	34.090	7,0
Bosnja dhe Hercegovina	6.127	1,4	6.203	1,3
Moldavia	19	0,0	57	0,0
EFTA	2.918	0,7	5.400	1,1
Zvicra	2.726	0,6	4.898	1,0
Icelanda	3	0,0	:	:
Norvegjia	180	0,0	489	0,1
Liechtensten	9	0,0	13	0,0
Vendet tjera evropiane	56.828	13,3	78.106	16,0
Turqia	51.406	12,0	75.293	15,4
Ukraina	2.908	0,7	832	0,2
Britania e Madhe	2.513	0,6	1.982	0,4
Vendet tjera jo evropiane	8.873	2,1	14.857	3,0
SHBA	4.299	1,0	5.648	1,2
Canada	121	0,0	230	0,0
Brazili	4.227	1,0	8.681	2
Mexico	225	0,1	298	0,1
Vendet nga Azija	51.362	12,0	55.198	11,3
Japonia	1.492	0,3	1.705	0,3
Kina	46.015	10,7	48.894	10,0
India	3.855	1	4.598	0,9
Të tjera	42.419	9,9	48.625	9,9

Shpjegime metodologjike

• Burimet

Statistikat e tregtisë së mallrave përbëhen kryesisht nga dokumentacioni i dorëzuar tek autoriteti doganor nga importuesit apo eksportuesit (ose agjentet e tyre). Ky dokument është Dokument Unik Doganor (DUD), i cili përdoret për qëllime të zhdoganimit. Informatat nga dokumenti barten në sistemi informativ doganor.

• Përgjegjësitë për mbledhjen, përpilimin dhe publikimin e të dhënave

Administrata doganore është përgjegjëse për mbledhjen, futjen dhe përpunimin e të dhënave të deklaratës doganore. Të dhënat në fushën e statistikave që regjistrohen në DUD, raportohen në baza mujore nga Administrata Doganore, në ASK, në mënyrë elektronike.

ASK-së është përgjegjës për përpunimin dhe publikimin e të dhënave të tregtisë së jashtme. Këto statistika përfshijnë të dhënat sipas llojit të procedurave doganore. Puna shtesë përfshinë korigjimin dhe miratimin e të dhënave doganore.

• Përfshirja

Statistikat e tregtisë së jashtme nuk përfshijnë importet dhe eksportet e mallrave të përkohshme, të cilat në gjendje të pandryshuar do të kthehen pas një kohe të caktuar, siç janë shërbimet, riparimet, parat në kuptimin e rrogave, paraja në ari, furnizimi i veturave kosovare jashtë vendit me derivate, importi i mallrave për zyrat ndërlidhëse dhe misioneve tjera diplomatike në Kosovë, bagazhi personal i udhëtarëve, mostrat komerciale dhe pakot postare me vlerë të ulët.

• Sistemi i regjistrimit

Statistikat e tregtisë së jashtme të mallrave janë të përpiluara sipas sistemit “të veçantë” (definicioni lehtësues) të regjistrimit të tregtisë ndërkombëtare. Sipas këtij sistemi importet dhe eksportet janë të regjistruara, në kohën kur mallrat lëvizin nëpër territor me qarkullim të lirë, e kjo është, pjesa brenda ku mallrat mund të shiten pa kufizime doganore. Definicioni lehtësues nënkupton që përveç transaksionit të rregullt të eksportit dhe importit, është i përfshirë edhe përpunimi i jashtëm dhe i brendshëm.

Eksportet e veçanta përfshijnë eksportet e mallrave: eksportet pas përpunimit të brendshëm, eksportet për përpunim të jashtëm dhe eksportet që nuk regjistrohen në dogana.

Importet e veçanta përbëhen nga importet e mallrave nga: Importet për përpunim të brendshëm(S.S), Importet pas përpunimit të jashtëm, Importet që nuk regjistrohen në dogana.

Të përjashtuara janë mallrat që janë në transit.

• Vlerësimi

Për importe, përdoret vlera cif (duke përfshirë koston, sigurimin dhe transportin e mallrave në pikën hyrëse në Kosovë). Për eksporte përdoret vlera fob (i lirë në bord). Ky është çmimi i mallrave të blerë jashtë vendit, përfshirë këtu paketimin, transportin brenda shtetit, çmimin për ngarkim, sigurimin si dhe shpenzimet tjera të cilat shfaqen kur mallrat vendosen në anije për eksportim, në aeroplan apo barten në zona të largëta. Vlera e faturës rillogaritet në vlerën e kufirit kosovar, duke shtuar apo zbritur, tërësisht apo pjesërisht, shpenzimet e transportit, ngarkimit, shkarkimit, të cilat varen nga kushtet e furnizimit të caktuara në kontratë.

Vlera përjashton:

- çdo shumë të pranuar nga eksportuesi gjatë rrugës së rifondimit, rikthimit të pagesës doganore, subversionimit apo nga ndonjë ndihme tjetër.
- çdo obligim të huaj doganor apo ndërrim të transportit të mallrave përveç në pikën doganore apo në pikën e eksportimit.

Vlera është në euro. Për transaksionet ku vlera është dhënë në një valutë tjetër, këmbimi në euro bëhet duke përdorur kursin javor të këmbimit valutor.

- **Periudha e referimit**

Muaji kalendarik është periudhë themelore për t'i mbledhur të dhënat. Duke u bazuar në të dhënat doganore, data e dorëzimit të deklaratës doganore apo datat tjera të vlefshme për implementimin e rregullave doganore, janë koha për t'i regjistruar transaksionet e importit/eksportit.

- **Njësitë e sasisë**

Sasia e mallrave të importuara dhe eksportuara tregohet në peshë neto, në qoftë se mund të caktohet, duke marrë parasysh natyrën e produktit si dhe në njësi plotësuese kur përshkruhet nga nomenklatura e tarifës doganore.

Pesha neto është njësi e zakonshme e sasisë së dhënë. Pesha e kontejnerëve, valixheve, qypave dhe materialeve paketues, janë të përjashtuara.

Njësitë tjera të sasisë përdorën për disa mallra më të rëndësishëm si, kafshë të gjalla, motorët e automjeteve, pajisjeve vendore, orëve, rrobave (ku si njësi matëse përdoret numri), këpucë (ku përdoret numri i palëve), mbështjellës për dysheme (ku përdoret metri katror) dhe pijet (ku përdoret vëllimi).

- **Shtetet partnere**

Në këtë publikim, importet janë të regjistruara sipas vendit të origjinës (si e kundërta e vendit të destinimit). Mallrat e marra ose të prodhuara në një vend me prejardhje po nga i njëjti vend. Një produkt në prodhimin e të cilit janë të përfshira dy a më tepër vende, si vendi i origjinës, konsiderohet vendi në të cilin është bërë përpunimi i fundit i rëndësishëm. Paketimi, ripaketimi, klasifikimi nuk konsiderohen si procese prodhuese.

Eksportet janë të klasifikuara sipas vendit të destinimit të fundit. Destinimi i fundit i mallrave konsiderohet shteti i fundit për të cilin mallrat janë dedikuar. Kjo nuk do të thotë se është shteti ku mallrat do të shkarkohen ose ku do të bëhet konsumi i fundit.

- **Klasifikimi i shtetit**

Nomenklatura e shteteve është klasifikimi i shteteve (gjeonomenklatura), sipas Gazetës Zyrtare të Komisionit Evropian, të publikuar çdo vit. Që nga janari 1999, përdoret sistemi ISO alfa 2 shifror i Kombeve të Bashkuara, ku secili shtet identifikohet me shifër të përbërë prej dy shkronjash.

- **Klasifikimi i mallrave**

Statistikat mblidhen duke përdorur Nomenklaturën e Kombinuar (NK) 8 shifror – tarifave dhe nomenklaturave statistikore të BE. Kjo nomenklaturë çdo vit udhëhiqet dhe azhurnohet nga komisioni në bashkëpunim me shtetet anëtare. NK përputhet me sistemin 6 shifror të Sistemit të Harmonizuar të Përshkrimit dhe Kodimit të Mallrave (SH) – Nomenklatura e Këshillit Doganor për Bashkëpunim cila përdoret në tërë botën për aplikimin e tarifave doganore dhe përpilimin e statistikave të tregtisë së jashtme. NK përmban rreth 10,400 8- shifra nën-krerë, 6 shifrat e para të të cilit janë të njëjta me shifrat e Sistemit të Harmonizuar (SH).

Klasifikimi standard i tregtisë (KST), versioni i ripunuar nr. 3 (SITC Rev 3), është zhvilluar nga Kombet e Bashkuara për krahasueshmëri të avancuar ndërkombëtare për statistika të tregtisë së jashtme.

Klasifikimi Standard i Tregtisë së Jashtme (KSTJ) versioni i ripunuar nr. 3 përmban rreth 3,100 krerë themelor (5- shifrore). Këto janë të kombinuara në 261 grupe (3-shifrore), 98 divizione (2-shifrore) dhe 10 seksione (1-shifror). Për shembull, Seksioni 6 (mallrat e fabrikuar të klasifikuara kryesisht sipas materialit) përbëhen nga 9 Divizione, 61 deri në 69. Divizion 64 (letër, karton dhe artikujt prej tyre) përbëhen nga dy grupe, 641 dhe 642, të cilat bashkërisht përbëjnë 72 krerë themelor, siç janë 642.94 (palloma, peshqirë, mbulesa për tavolina, dhe të ngjashme).

KSTJ versioni i ripunuar nr. 3 është identik me strukturën e Sistemit të harmonizuar. Secila kategori e KSTJ (duke përfshirë të gjithë krerët themelor) është ekuivalent me kombinimin e krerëve të SH (prandaj edhe të kombinimit të krerëve të NK).

- **Publikimi i të dhënave**

Të dhënat mujore janë të përkohshme dhe publikohen 24 ditë pas muajit referues.

Të dhënat vjetore publikohen në qershor.

- **Publikimi**

Të dhënat e publikuara të statistikave të tregtisë së jashtme janë:

Të dhënat e grupuara publikohen në web faqen e ASK-së, 24 ditë pas periudhës referuese.

- **Çdo muaj:**

Statistikat mujore të tregtisë së jashtme të Kosovës.

- **Çdo vit:**

Të dhënat përfundimtare

Statistikat e tregtisë së jashtme të Kosovës

- **Rrjedhat e eksportit dhe të importit per muajin Tetor 2022**

Të dhënat nga Tregtia e Jashtme të Mallrave në Kosovë tregojnë për një deficit tregtar më të larët për (13.0%) në muajin Tetor 2022, në raport me periudhën e njëjtët të vitit 2021, gjegjësisht në vlerë prej 402,3 milion euro krahasuar me deficitin 355,9 milion euro në vitin 2021. Eksporti mbulon importin (17.7%).

Eksporti i mallrave në muajin tetor 2022 kishte vlerën 86,4 milion euro, ndërsa importi 488,7 milion euro, është një rritje prej (19.1%) për eksport si dhe (14.1%) për import duke krahasuar me periudhën e njëjtët të vitit 2021.

Sipas të dhënave të grupeve kryesor të eksportit e përbëjnë: (20.7%) produktet minerale, (18.5%) metalet bazë dhe artikujt prej tyre, (14.9%) artikuj të ndryshëm të prodhuar, (13.3%) plastikë, gomë dhe artikuj prej tyre, (7.1%) ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani, (5.3%) produkte bimore, etj.

Ndërsa sipas të dhënave të grupeve kryesor për import e përbëjnë: (16.8) produktet minerale, (11.8%) makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike, (10.3%) metalet bazë dhe artikujt prej tyre, (10.2%) ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani, (10.2%) produkte të industrisë kimike, (7.6%) mjetet e transportit, (6.0%) plastikë, gomë dhe artikuj prej tyre, etj.

- **Tregtia e jashtme e mallrave me vendet e BE-së 27**

Eksportet e Kosovës në vendet e BE-së arritën në 37,7 milion euro, ose rreth (43.7%) e eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej (65.5%). Partneret kryesor për eksportin e mallrave në BE janë: Sllovenia (14.1), Gjermania (10.1%), Italia (5.4%), Holanda (3.3%), etj.

Importet e Kosovës nga vendet e BE-së ishin rreth 203,3 milion euro, ose (41.6%) e importeve të përgjithshme, me një rritje prej (15.7%). Importet me pjesmarje më të lartë ishin nga: Gjermania (10.6%), Greqia (4.8%), Italia (4.7%), Belgjika (4.0%), etj.

- **Tregtia me vendet e CEFTA-së.**

Në muajin tetor 2022, eksportet e Kosovës me vendet CEFTA-së arritën në 28,5 milion euro, ose (33.1%) të eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej (18.4%). Partner kryesor për eksport nga vendet e CEFTA-së janë: Maqedonia (12.9%), Shqipëria (8.7%), Serbia (6.4), Mali i zi (4.0%).

Ndërsa, importet nga vendet e CEFTA-së në muajin tetor 2022, arritën në 83,2 milion euro, ose (17.0%) të importeve të përgjithshme, me një rënje prej (7.9%). Vendet me pjesmarje më të lartë për import ishin: Serbia (7.0%), Shqipëria (4.4%), Maqedonia (4.0%).

- **Tregtia me vendet e tjera të botës**

Eksportet e Kosovës me vendet tjera arritën në 20,0 milion euro, ose (23.2%). Si partner më të rëndësishëm nga këto vendet për eksport vlen të përmendën: SHBA (9.4%), dhe Zvicra (8.5%).

Ndërsa importet e Kosovës me vendet tjera arritën në 202,1 milion euro, ose (41.4%). Vendet me pjesmarje më të lartë për import në këtë grup ishin: Turqia (15.4%) dhe Kina (10.0%).

- **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,**
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- **Telefoni:** +383 (0) 38 200 31 129
Kryeshefi Ekzekutiv: +383 (0) 38 200 31 112
- **Fax:** +383 (0) 38 235 033
- **E-mail:** infoask@rks-gov.net
- **Ueb-faqe:** <http://ask.rks-gov.net>
- © : Agjencia e Statistikave të Kosovës,
- Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.